



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në Vendimin (Nr. 07-V-014) e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbledhjes plenare të mbajtur më 03 qershor 2020, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

**për sistemim të përkohshëm të strukturave të ish MIE-së**

1. Zhvendosen strukturat organizative përkohësisht nga ish Ministria e Integritit Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të mbikëqyrë funksionimin administrativ të strukturave organizative të ish Ministrisë së Integritit Evropian në realizimin e detyrave në kuadër të ZKM-së, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit që të fillojë procedurën e hartimit të Koncept-dokumentit për themelimin e Agjencisë për Integritim Evropian, dhe pas kalimit të procedurave edhe hartimin e Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Integritim Evropian.
4. Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, ish Ministria e Integritit Evropian, si organizatë aktuale buxhetore do të vazhdojë t'i përmbush obligimet financiare në përputhje me Ligjin Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pas marrjes së Vendimit (Nr. 07-V-014) të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbledhjes plenare të mbajtur më 03 qershor 2020, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe pas miratimit të Rregullores (QRK) – Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) – Nr. 07/2020, në mënyrë që të mos mbeten strukturat e ish Ministrisë së Integritit Evropian të pa sistemuara, Qeveria e Republikës së Kosovës marrë parasysh rëndësinë e procesit të integritit evropian dhe vazhdimin të përmbushjes së obligimeve në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19, 50 (4) (5) dhe 52 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet "Këshilli i Ekspertëve për Dialog me Serbinë" (më tutje "Këshilli") si zyrë e veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Këshilli bënë analiza specifike dhe këshillon Kryeministrin dhe Qeverinë për çështjet e dialogut me Serbinë sipas temave që diskutohen në Dialog, si dhe përgatitë raporte, dokumente për pozicionin e Kosovës, dokumente analitike e faktografike dhe dokumente tjera sipas nevojës.
3. Kryeministri emëron "Koordinatorin Shtetëror për Dialog", i cili udhëheq me punën e Këshillit, është njëkohësisht edhe këshilltar i Kryeministrit dhe i përgjigjet drejtpërdrejt atij.
4. Koordinatorin Shtetëror për Dialog është person kontaktues dhe koordinues në emër të Kryeministrit me të gjitha palët sa i përket procesit të Dialogut.
5. Koordinatorin Shtetëror për Dialog, në konsultim me Kryeministrin, sipas temave të Dialogut, fton si anëtarë në Këshill ekspertë nga institucionet publike, institucionet akademike dhe shoqëria civile, si dhe ekspertë të tjerë që kanë kompetencë profesionale për temat përkatëse.
6. Koordinatorin Shtetëror për Dialog, sipas nevojës mund të ftojë në Këshill edhe ekspertë të jashtëm për mbështetje të punës dhe përgjegjësive të Këshillit, të cilët do të kompensohen sipas legjislacionit në fuqi.
7. Buxheti i Këshillit përcaktohet me vendim të Qeverisë, në përputhje me ligjet në fuqi.
8. Zyra e Kryeministrit, Ministrisë dhe institucionet tjera përkatëse, i ofrojnë mbështetje Koordinatorit Shtetëror për Dialog dhe Këshillit të Ekspertëve, sipas përgjegjësive që kanë.
9. Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ofron shërbimet e sekretarisë për Koordinatorin Shtetëror për Dialog dhe Këshillin e Ekspertëve përgjatë procesit të Dialogut.
10. Koordinatorit Shtetëror për Dialog i lejohet angazhimi i dy ndihmësve (asistentëve) profesional të përkohshëm, sipas legjislacionit në fuqi.
11. Zyra e Kryeministrit merr përsipër krijimin e kushteve të nevojshme për mbarëvajtjen e punës së Koordinatorit Shtetëror për Dialog dhe Këshillit të Ekspertëve.

12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për bartjen e funksioneve nga Zyra e Kryeministrit te Institucionet kompetente**

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës nga Zyra e Kryeministrit bartet në Ministrinë e Financave.
2. Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, bartet nga Zyra e Kryeministrit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
3. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/18 i datës 11.03.2015, kështu që teksti i pikës 5 fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim: "Këshilli Ndërmintor për Ujëra, do të ketë Sekretariatit e tij, i cili do të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.  
  
3.1. Shfuqizohet paragrafi 2 i nenit 15 të Rregullores QRK - nr. 11/2014 për Punën e Këshillit Ndërmintor për Ujërat.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit që në pajtim me legjislacionin në fuqi të ndërmarrin të gjitha masat ligjore, financiare dhe administrative për bartjen e Agjencisë, Sekretariatit dhe Zyrës, të cekura në këtë vendim.
5. Ndryshimet e nevojshme të reflektohen gjatë përgatitjes së Buxhetit për vitin 2021.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01\04, i datës 22 shtator 2017 dhe Vendimi i Qeverisë Nr. 04/101, i datës 2 maj 2019, për Komisionin Shtetëror për Shënjimimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni i Ministrave për Ndërmarrjet Publike, në këtë përbërje:

|  |           |
|--|-----------|
| 1.1. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, | kryesues; |
| 1.2. Ministri i Financave,               | anëtar;   |
| 1.3. Ministri i Infrastrukturës,         | anëtar;   |
| 1.4. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, | anëtar;   |
| 1.5. Ministri i Zhvillimit Rajonal,      | anëtar.   |
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij vendimi do t'i paraqesë Qeverisë së Republikës së Kosovës propozime ose vërejtje për Ndërmarrjet Publike.
3. Ky vendim zëvendëson dhe shfuqizon Vendimin e Qeverisë Nr. 05/07, të datës 06.10.2017.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 dhe në nenin 51 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Komiteti Drejtues i Projektit të Asistencës Teknike - Energjia nga Linjiti, përgjegjës për projektin Termocentrali "Kosova e Re", themelohet me përbërjen si në vijim;

|  |           |
|--|-----------|
| 1.1. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit,                         | kryesues; |
| 1.2. Ministri i Financave,                                       | anëtar;   |
| 1.3. Ministri i Infrastrukturës,                                 | anëtar;   |
| 1.4. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë,                         | anëtar;   |
| 1.5. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale,                    | anëtar;   |
| 1.6. Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit,                      | anëtar;   |
| 1.7. Kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,            | anëtar;   |
| 1.8. Kryesuesi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, | anëtar.   |
2. Komiteti Drejtues i Projektit vendosë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me Termocentralin "Kosova e Re", sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ky vendim zëvendëson dhe shfuqizon Vendimin e Qeverisë Nr. 05/06, të datës 10.03.2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Anulohen vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës; Nr. 06/06, i datës 10 mars 2020 dhe Nr. 02/15, i datës 23 mars 2020.
2. Themelohet Grupi punues ndërinstitucional me AKP-në për draftimin e Strategjisë për Privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore në harmoni me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të përmbylljes së suksesshme të procesit të privatizimit të pronave shoqërore.
3. I kërkohet Agjencionit Kosovar të Privatizimit që të mos bëjë shpallje të asnjë vale të re të privatizimit deri sa të miratohet Strategjia sipas pikës së mësipërme.
4. Autorizohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Ministria e Financave që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për themelimin e grupit punues dhe të ofrojnë të gjitha resurset e nevojshme për draftimin e Strategjisë në pikën 2 të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Botërore, e përfaqësuar nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, për financimin e "Programi - Nxitja dhe levimi i mundësive për Sigurinë e Ujit".
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Komisionit të Ankesave për të Huajt (në tekstin në vijim: "Komisioni")**

1. Komisioni ka këtë përbërje:
  - 1.1. Agron Gashi, Zyra e Kryeministrit - kryesues;
  - 1.2. Esad Veliu, Ministria e Drejtësisë - zv. kryesues;
  - 1.3. Arben Kqira, Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
  - 1.4. Bashkim Shala, Ministria e Arsimit dhe Shkencës - anëtar;
  - 1.5. Jeton Maliqi, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - anëtar;
  - 1.6. Samire Bajraktari, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - anëtare;
  - 1.7. Leutrim Zabelaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - anëtar.
2. Mandati i Komisionit është tre (3) vjet dhe është i pavarur në punën e tij.
3. Komisioni mund të vendosë edhe në panel prej 3 (tre) anëtarësh, dhe i njëjti merr vendime me shumicë votash.
4. Përfaqësuesi i UNCHR-it mund të merr pjesë në punën e Komisionit në cilësinë e vëzhguesit.
5. DSHAM/MPB luan rolin e Sekretariatit të Komisionit dhe të njëjtit i ofron kushte teknike për ushtrimin e përgjegjësisë.
6. Komisioni gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive e zbaton Ligjin në fuqi për të huajt dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, Ligjin në fuqi për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik si dhe legjislacionin tjetër i cili është relevant në ushtrimin e përgjegjësisë së Komisionit.
7. Obligohen Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë e përmendura në pikën 1. të këtij vendimi për zbatimin e këtij vendimi.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/26 i datës 04.05.2015 dhe Vendimi Nr. 03/25 i datës 22.01.2018.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/09

Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 75 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil dhe të nenit 4 dhe nenit 5 të Rregullores Nr. 29/2018 e Punës së Komisionit Kombëtar për Refugjatë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Kombëtar për Refugjatë, në përbërjen si në vijim:
  - 1.1. Mergim Himaj, Ministria e Punëve të Brendshme - kryesues;
  - 1.2. Leunora Ahmeti, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - zëvendëskryesuee;
  - 1.3. Nehat Pllana, Zyra e Kryeministrit - anëtar;
  - 1.4. Shkelqim Jakupi, Ministria e Pushtetit Lokal - anëtar;
  - 1.5. Ruzhdi Osmani, Ministria e Drejtësisë - anëtar;
  - 1.6. Aferdita S. Hoxha, Ministria e Shëndetësisë - anëtare;
  - 1.7. Shkodran Manaj, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil - anëtar.
2. Komisioni është i pavarur në punën e tij.
3. Mandati i Komisionit është tre (3) vjet dhe veprimtarinë e tij e ushtron në bazë të Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil si dhe legjislacionit relevant në fuqi.
4. Komisioni vendosë në këshilla prej tre (3) anëtarësh, dhe i njëjti merr vendime me shumicë votash.
5. Përfaqësuesi i UNHCR-it, merr pjesë në punën e Komisionit në cilësinë e vëzhguesit.
6. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Komisionin me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 10/66 i datës 18.09.2018.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/09  
Datë: 01.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4), si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, si dhe pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 korrik 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19 miratohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për ndërmarrjen e masave si në vijim:
  - 1.1. Reduktimi i punonjësve në administratë vetëm në staf esencial dhe angazhimi i tyre me punë nga shtëpia (online), përgjysmimi i personave në secilën zyrë në përputhje me manualin.
  - 1.2. Të mbylLEN zyrat apo njësitë në të gjitha institucionet publike, dhe biznese private ku ka raste pozitive.
  - 1.3. Për personat me të cilën ka pasur kontakt personi tashmë i konfirmuar me Covid-19 pozitiv, zbatohen protokollat në fuqi.
  - 1.4. Kontaktet duhet të vet-izolohen për 14 ditë në shtëpi, dhe nuk duhet të kenë asnjë kontakt gjatë kësaj periudhe.
  - 1.5. Kontaktet këshillohen për monitorim të shëndetit për 14 ditë pas datës së fundit të ekspozimit dhe të kërkojnë kujdes të menjëhershëm shëndetësor nëse shfaqin ndonjë simptomë (ethe, temperaturë, kollitje, vështirësi në frymëmarrje ose diarre).
  - 1.6. Të gjitha rastet pozitive dhe kontaktet e tyre, mbikëqyren nga shtabet Komunale, kontrollohen nga inspektorati, QKMF dhe organet e rendit.
  - 1.7. Në mënyrë rigoroze të respektohen masat mbrojtëse të vendosura nga IKShPK.
  - 1.8. Në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, përdorimi i maskave, dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura.
  - 1.9. Inspektoratet sanitare të AUV dhe inspektoratet komunale të zbatojnë ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe të merren masa në raste të mos zbatimit eventuale të rekomandimeve të IKShPK.
  - 1.10. Punëtorët shëndetësorë t'i përmbahen rekomandimeve të IKShPK në përdorimin e masave mbrojtëse duke ruajtur kështu shëndetin e tyre, të pacientëve dhe të gjithë qytetarëve të vendit.
  - 1.11. Bartja e maskave të jetë obligative.

- 1.12. Institucionet që ofrojnë shërbime përmes sporteve, janë të obliguara, si punonjës ashtu edhe palët të mbajnë maskë, të respektohet distanca prej 2 metra në pritje në radhë me mundësi të pritjes në hapësirat e jashtme sipas Manualit për luftimin e Covid-19.
- 1.13. Kontroll rigoroze e bartjes së maskave në hyrje të çdo institucioni.
- 1.14. Bartja e obliguar e maskës në transportin publik, taksive si të punonjës ashtu edhe të udhëtarëve, të respektohet distanca prej 2 metra, ajrosja natyrale (hapja e dritareve) dhe dezinfektimi i automjeteve së paku dy herë gjatë ditës.
- 1.15. Ndërprehen aktivitetet në sektorin e identifikuar të institucioneve përkatëse të listuar sipas gjurmimit aktiv epidemiologjik.
- 1.16. Bartja e obligueshme e maskave nga organet e rendit (zyrtarët policorë).
- 1.17. Ndalim i vizitave të familjarëve të pacientëve në institucionet shëndetësore (lejohe vetëm një përcjellës sipas nevojës).
- 1.18. Reduktimi i operacioneve efektive në institucionet shëndetësore.
- 1.19. Bartja e obligueshme e pajisjeve personale mbrojtëse në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private brenda dhe jashtë institucioneve.
- 1.20. Kontroll rigoroze e inspektoratit shëndetësor në institucionet shëndetësore.
- 1.21. Ndalohet grumbullimet në hapësirat e mbyllura dhe të hapura për më shumë se 50 persona.
- 1.22. Kontroll i rreptë nga organet e inspektoratit dhe policisë për respektimin e distancës prej 2m dhe bartja e maskës në çdo hapësirë të mbyllur (zyra, qendrat tregtare, sportele) dhe të hapura (gastronomia në tërësi).
- 1.23. Në veçanti veprimtarit tregtare (markete, furra e bukës, barnatoret etj.) dhe gastronomia janë të obliguara të bartin maska dhe qasje të lehtë dhe të vazhdueshme në përdorimin e dezinfektuesve.
- 1.24. Ceremonitë mortore të zhvillohen vetëm me rrethin e ngushtë familjar.
- 1.25. Angazhohen organet përkatëse të mbikëqyrin zbatimin e këtyre masave.
- 1.26. Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHPK do përcjellin gjendjen dhe nëse rëndohet situata, atëherë do të kërkohet kthimi i masave rigoroze të rekomanduara sipas OBSH.
- 1.27. Komunat të aktivizojnë plotësisht shtabet lokale.
- 1.28. Zbatimi i masave shtesë të mbrojtjes për shtëpitë e pleqve.

## A R S Y E T I M


Që kur ka filluar lehtësimi i masave për disa aktivitete, kemi gjurmuar raste të reja të Covid-19 duke u shtuar rreziku të shpërthejnë vatra të reja epidemike në disa Komuna të Kosovës dhe institucione e degë të ekonomisë, për shkak të mos mbajtjes së distancës dhe mos mbajtjes së maskave.

Duke pas parasysh se në javët e fundit kemi rritje të rasteve pozitive që në intensitet krahasohen me mesin e muajit Prill dhe kemi raste të punëtorëve të organizatave si: Posta e Kosovës, KEK, KEDS, Galeria e Arteve, Institucionet bankare, Prokuroritë, institucionet shëndetësore, Agjensionet, kompani tregtare dhe biznese private, rekomandojmë të mbyllet sektorët ku ka raste pozitive dhe të gjitha rastet pozitive dhe kontaktet e tyre të mbahen në vet-izolim dhe bartja e maskave është obligative.

Këto dite vërehet fluks i shtuar i qytetarëve kudo nëpër Kosovë. Kjo është sjellje e rrezikshme dhe lehtësimi i lëvizjes nuk nënkupton mos respektimin e rekomandimeve të IKSHPK dhe Ministrisë së Shëndetësisë në mbajtjen e distancimit fizik dhe mbajtjen e maskave në vendet publike.

Pakujdesia e disa qytetarëve gjatë këtyre aktiviteteve, mund të shtojnë rrezikun e përhapjes së infeksionit për derisa virusi SARS-COV-2 është prezent dhe kështu mund të mbingarkohet sistemi shëndetësor me pasoja të paparashikuara deri në shpërthimin e që mund të paraqes rrezik për jetën e qytetarëve.

**Avdullah HOTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë